



REPubLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
DREJTORIA E TARIFAVE DHE ÇMIMEVE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.09.2022

**RELACION**  
**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË FSHU SH.A. LIDHUR ME KOSTOT QË DUHET TË PËRFSHIHEN NË LLOGARITJEN E ÇMIMIT ME PAKICË TË ENERGJISË PËR KLIENTËT FAMILJARË ME KONSUM MBI 800 KWH NË MUAJ.**

**Tiranë**

Të Nderuar anëtarë të Bordit,

Shoqëria FSHU sh.a. me anë të shkresës nr. 6358, date 20.09.2022 ka paraqitur pranë ERE-s kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për konsumin e energjisë elektrike mbi 800 kwh/muaj për klientët familjar për periudhën tetor – dhjetor 2022, pasi është bërë me dije nga Koorporata Elektroenergjetike Shqiptare mbi Vendimin e Asemblesë së Përgjithshme të Aksionarit Nr. 6645/1, datë 08.09.2022, në të cilën është vendosur që çmimi i shitjes nga KESH sh.a për energjinë e furnizuar për mbulimin e kërkesës për energji elektrike të klientëve familjarë me konsumin mbi 800 kWh/muaj të jetë 34.3 Lekë/kWh.

Shoqëria FSHU sh.a. deklaroi se ky ndryshim në rritjen e çmimit të blerjes së energjisë elektrike për sasinë e konsumuar nga klientët familjarë mbi 800 kWh/muaj do të rrisë shpenzimet e blerjes së energjisë për periudhën Tetor – Dhjetor 2022 me rreth 1.8 miliard Lekë sipas parashikimeve në tabelën në vijim:

Niveli Tensionit	Kategoria	Tetor		Nëntor		Dhjetor		3-mujori	Çmimi mesatar i Blerjes (Ishte) Lekë/Kwh	Çmimi mesatar i Blerjes (Bëhet) Lekë/Kwh	Rritja e Shpenzimeve të Blerjes Lekë
		Nr Ab.	Kwh	Nr Ab	Kwh	Nr Ab	Kwh				
0.4 kv	Familjare >800 Kwh)	49,334	19,568,211	71,278	16,566,827	71,278	21,299,059	57,434,097	2.60	34.30	1,820,660,861
<b>Total</b>		<b>49,334</b>	<b>19,568,211</b>	<b>71,278</b>	<b>16,566,827</b>	<b>71,278</b>	<b>21,299,059</b>	<b>57,434,097</b>			<b>1,820,660,861</b>

FSHU sh.a. në kërkesën e saj ka kërkuar përfshirjen e çmimit të energjisë elektrike për nivelin e konsumit mbi 800 kWh, kostot si më poshtë vijon:

Nr.	Shpenzime të FSHU në çmimin e shitjes	Kosto Lekë për kWh të Shitur
1	Tarifa e Shpërndarjes	6.42
2	Tarifa e Transmetimi	0.85
3	Kosto Administrative	1.21
4	Amortizimi	0.01
5	Disbalanca	0.07
6	Kosto e lejuar e kapitalit të punës	0.03
7	Marzhi	0.06
	<b>Shpenzime FSHU</b>	<b>8.65</b>

Në vijim shoqëria deklaron se:

1. Shtesa e shpenzimeve të blerjes së energjisë do të duhet te rrisë edhe koston vjetore të blerjes se energjisë per vitin 2022, vlerësuar nga ERE në vlerën 11,994 milion Lekë me 1820 milion lekë sikurse evidentohet në tabelën e mësipërme .
2. Shpenzimet faktike bazuar në të dhënat e 8-mujorit dhe të parashikuara për gjithë vitin 2022 si dhe ato për vitin 2023, janë të ndryshme nga ato të marra në konsideratë në llogaritjet e ERE, për korrigjimin e të cilave FSHU SH.A. do të shprehet në dokumentin e aplikimit për çmime të shitjes me pakicë për klientët që furnizohen nga FSHU.
3. Sipas parashikimeve të FSHU SH.A. ndër të tjera në përlllogaritjen e kostove duhet të plotësohen me koston e blerjes së energjisë si dhe me koston e shtuar të Borxhit të Keq të ndikuar nga rritja e çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga KESH për klientët familjarë me konsum mbi 800 kWh/muaj.

Kosto për njësi e Borxhit të Keq në vendimin e Bordit të ERE me nr.74, datë 13.04.2022 Mbi vlerësimet e ERE për kostot e aktivitetit të Furnizuesit të Shërbimit Universal për periudhën 1.05.2022 – 31.12.2022, është llogaritur të jetë 0.53 Lekë / kWh. Ndërkohë FSHU ka kërkuar ti njihet një kosto e borxhit të keq në nivelin 0.68 lekë/kWh si rezultat i rritjes së çmimit të blerjes së energjisë për periudhën Tetor – Dhjetor nga KESH, e cila është përlllogaritur bazuar në normën e arkëtimit të përdorur në këto llogaritje prej 95% sipas Vendimeve të Qeverisë Shqiptare në Planin e Konsolidimit Financiar.

Llogaritjet e paraqitura nga FSHU lidhur me parashikimin e energjisë që pritet të shitet në periudhën tetor - dhjetor 2022 sipas grupeve të klientëve dhe nivelit të tensionit për koston e shtuar të Borxhit të Keq evidentohen në tabelën në vijim:

## PARASHIKIM I SHITJES SE ENERGJISE PER PERIUDHEN JANAR - DHJETOR 2022

Nr.	Niveli Tensionit	Kategoria	Tetor		Nëntor		Dhjetor		3-mujori	Çmimi mesatar i shitjes	Të Ardhura	Borchi i keq (5%)	Borchi i keq
			Nr Ab	Kwh	Nr Ab	Kwh	Nr Ab	Kwh					
1	35 Kv (FMF)	Jo-familjare	18	2,443,343	18	1,870,920	18	1,991,232	6,305,695	33.04	208,340,159	10,417,008	1.65
2	20/10/6 KV	Jo-familjare	7,804	78,169,284	7,804	89,301,387	7,804	95,044,006	262,514,676	18.72	4,913,093,679	245,654,684	0.94
3	0.4 kv	Jo-familjare	174,744	105,323,126	174,744	113,925,381	174,744	121,251,472	340,499,979	13.67	4,654,443,817	232,722,191	0.68
4	0.4 kv	<b>Familjare Total</b>	<b>867,449</b>	<b>264,313,556</b>	<b>829,857</b>	<b>274,550,975</b>	<b>829,857</b>	<b>292,206,262</b>	<b>831,070,793</b>		<b>9,761,780,673</b>	<b>488,089,034</b>	<b>0.59</b>
4.1	0.4 kv	a) Familjare 1-800 Kwh	818,115	206,164,373	758,579	200,961,748	758,579	213,884,804	621,011,125	9.50	5,899,605,690	294,980,285	0.48
	0.4 kv	b) Familjare mbi 800 Kwh	49,334	58,148,982	71,278	73,589,227	71,278	78,321,459	210,059,668		3,862,174,982	193,108,749	0.92
4.2	0.4 kv	b1) 800+ (Familjare 1-800 Kwh)	49,334	38,580,771	71,278	57,022,400	71,278	57,022,400	152,625,571	9.50	1,449,942,927	72,497,146	0.48
4.3	0.4 kv	b2) 800+ (Familjare 800 + Kwh)	49,334	19,568,211	71,278	16,566,827	71,278	21,299,059	57,434,097	42.00	2,412,232,055	120,611,603	2.10
	Total		1,050,015	450,249,508	1,012,423	479,648,663	1,012,423	510,492,972	1,440,391,143		19,537,658,327	976,882,916	0.68

**Vlerësimet e ERE lidhur me kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a. për kostot shtesë që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë për klientët familjarë me konsum mbi 800 kWh/muaj.**

Në mbështetje të nenit 83 dhe 85 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, Enti Rregullator i Energjisë është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e çmimeve të rregulluara për klientët fundorë që furnizohen sipas shërbimit universal të furnizimit.

Bordi i ERE me anë të vendimit nr. 74, datë 13.04.2022, kreu vlerësimet e saj për kostot e aktivitetit të furnizuesit të shërbimit universal për periudhën 01.05.2022 – 31.12.2022 duke konsideruar dhe transferimin e kostove të aktivitetit të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, përfshirë dhe koston e blerjes së energjisë elektrike duke përlllogaritur efektet e tyre në çmimet e shitjes me pakicë të klientëve fundorë që shërbehen nga FSHU sh.a. për periudhën 01.05.2022 – 31.12.2022. Me anë të vendimit sipërcituar ERE vendosi se çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për periudhën 1Maj – 31 Dhjetor 2022 janë ato të miratuara me anë të vendimit të bordit të ERE-s nr. 252, datë 21.12.2021.

Kërkesa e paraqitur nga shoqëria FSHU sh.a. vjen për arsye të rritjes së koston së blerjes së energjisë elektrike që prokurohet për qëllime të mbulimit të nevojës së FSHU sh.a. nga shoqëria KESH sh.a. sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 456, datë 29.06.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, si dhe mbështetur në vendimin e Asemblesë së Përgjithshme Nr. 6645/1, datë 08.09.2022 të shoqërisë KESH sh.a. në të cilën është vendosur që çmimi për energjinë e furnizuar për mbulimin e kërkesës për energji elektrike të klientëve familjarë për konsumin mbi 800 kWh/muaj të jetë 34.3 Lekë/Kwh.

Sa më sipër FSHU sh.a. ka kërkuar njohjen e kostos së blerjes së energjisë elektrike për klientët familjar që do të konsumojnë mbi 800 kWh/muaj me një vlerë prej **1,820 milion lekë** për periudhën Tetor – Dhjetor 2022, e cila bashkë me kostot e tjera shoqëruese të evidentuara më sipër, rezulton me një çmim shitje të energjisë elektrike për këtë kategori klientësh prej **42.95 lekë/kWh**.

Neni 90, pika 5 e ligjit 43/2015 “Për Sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, parashikon se:

*Në situata emergjente, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë dhe pas marrjes së mendimit të Komitetit për Emergjencat Civile, Këshilli i Ministrave mund të vendosë mbi të licencuarit detyrimin e shërbimit publik në lidhje me sigurinë e furnizimit, duke përfshirë detyrimin e importit të energjisë elektrike, detyrimin e furnizimit vetëm të kategorive të caktuara të klientëve ose kushte të tjera të veçanta në kryerjen e aktiviteteve të licencuara. Ky detyrim do të jetë në përpjesëtim me emergjencën dhe nuk duhet të shtrihet përtej periudhës së nevojshme për kapërcimin e kësaj situatë.*

Në vijim të gjendjes së emergjencës për furnizimin me energji elektrike, Këshilli i Ministrave me anë të vendimit nr. 456, datë 29.6.2022, vendosi të miratojë kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike.

Në nenin 4, pika 7 të këtij vendimi përcaktohet se ky vendim është i zbatueshëm edhe për përballimin e situatës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, sipas nenit 90 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, për të cilën Këshilli i Ministrave me anë të vendimit Nr. 256, datë 29.4.2022 vendosi se gjendja e emergjencës në furnizimin me energji elektrike i shtrin efektet deri më 31 dhjetor 2022.

Detyrimi i shërbimit publik i vendosur nga Këshilli i Ministrave, ndër të tjera përcakton detyrimin e KESH sh.a. për furnizimin me energji elektrike për të gjithë klientët të cilët furnizohen në kushtet e shërbimit universal nga shoqëria FSHU sh.a.. Në pëputhje me këtë VKM, asambleja e përgjithshme e aksionarit të KESH sh.a. me anë të vendimit nr. 6645/1, datë 08.09.2022 ka vendosur në pikën 1 të tij: Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për FSHU sh.a. sipas tabelës si vijon:

Energji e shitur për konsum klientë familjar në TU, deri në 800 kWh/Muaj	2.6 ALL/KWh
Energji e shitur për konsum klientë familjar në TU, mbi 800 kWh/Muaj	34.3 ALL/KWh
Energji e shitur për konsum klientë jo familjar në TU	2.6 ALL/KWh
Energji e shitur për konsum klientë në Tension të mesëm TM, 6/10/20 KV	12 ALL/KWh

Çmimi i aplikueshëm për konsumin mbi 800 kWh/muaj për klientët familjarë do të mbulojë kostot e blerjes së energjisë, të cilat janë rritur në mënyrë eksponenciale në tregun rajonal dhe europian të energjisë. Ky propozim nuk prek çmimin e shitjes së energjisë elektrike për klientët familjar që konsumojnë deri në 800

kWh/muaj, si dhe të gjithë klientët jofamiljarë, për faktin se nuk ka ndryshim të tarifave të përdorimit të rrjeteve të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.

Sa i përket aspektit procedural të kësaj vendimmarrje sqarojmë se: Ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 90 “Situatat emergjente në furnizimin me energji elektrike”, pika 1, germa “ç” ka përcaktuar se Këshilli i Ministrave mund të shpallë gjendjen e emergjencës në furnizimin me energji elektrike në rast të: ç) mungesave afatgjata të burimeve parësore energjetike për prodhimin e energjisë elektrike.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “ç”, të pikës 1, të nenit 90, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 584, datë 08.10.2021, shpalli gjendjen e emergjencës në furnizimin me energji elektrike deri më 15 prill 2022. Në vijim, me Vendimin nr. 256, datë 29.4.2022 «Për disa ndryshime në Vendimin nr. 584, datë 08.10.2021 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”», Këshilli i Ministrave vendosi shtrirjen e efekteve të gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike deri më 31 dhjetor 2022.

Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU sh.a) në shkresën me nr. 6358 prot., datë 20.09.2022, me lëndë “Lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë, për klientët familjarë me konsum mbi 800 Kwh në muaj” ka theksuar se për shkak të ndryshimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga KESH sh.a, do të sjellë një rritje të kostove vjetore të blerjes së energjisë elektrike për shoqërinë FSHU sh.a.

Për sa më sipër, vleresojmë se kërkesa e paraqitur nga shoqëria FSHU sh.a. mbi nevojën e përballimit të kostove shtesë për blerjen e energjisë elektrike, përbën interes të lartë publik në kuadër të garantimit të furnizimit me energji elektrike dhe të menaxhimit të situatës së krizës energjetike, për të cilën Këshilli i Ministrave ka shpallur gjendjen e emergjencës, si dhe është e mbështetur në Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, i cili përcakton se ***qëllimi i kryesor i tij është garantimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike të klientëve fundorë.***

Ne kuptim të sa më sipër, sqarojmë se Kodi i Procedurave Administrative në nenin 12, parashikon, ndër të tjera se *çdo veprim administrativ, i cili, për arsye të mbrojtjes së interesit publik ose të të drejtave të të tjerëve, mund të cenojë interesa legjitime, zhvillohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Veprimi administrativ është në përputhje me parimin e proporcionalitetit vetëm kur ky veprim është: a) i nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që cenojnë më pak të drejtat apo interesat legjitime të palës; b) i përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj; dhe c) në përputhje me nevojën që e ka diktuar atë.*

Sa i përket parimit të proporcionalitetit është vlerësuar se kërkesa e paraqitur për shqyrtim nga shoqëria FSHU sh.a. pranë ERE-s, i plotëson kushtet e parashikuara në nenin 12 të KPA, duke marrë në konsideratë garantimin e furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike të klientëve fundorë si dhe gjendjen e emergjencës në furnizimin me energji elektrike, të shpallur nga Qeveria Shqiptare.

Për gjithë sa më sipër, vlerësojmë të nevojshme njohjen e kostove shtesë të blerjes së energjisë nga shoqëria e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për furnizimin me energji elektrike të klientëve të cilët

furnizohen nga furnizuesi i shërbimit universal, përtej atyre të pranuara në vendimin nr. 74, datë 13.04.2022 të Bordit të ERE, me qëllim sigurimin e likuiditetit të nevojshëm për realizimin e aktivitetit të furnizimit të energjisë elektrike mbështetur në detyrimin e shërbimit publik.

**Përlllogaritja e çmimit të shitjes së energjisë elektrike mbi 800 kWh/muaj për konsumatorët familjarë për periudhën 1 tetor - 31 dhjetor 2022.**

Të ardhurat e kërkuara të rillogaritura për periudhën e mbetur të vitit afektohen në rritje si pasojë e ndryshimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria KESH sh.a prej 34.3 lekë/kWh për konsumin familjar mbi 800 kWh/muaj dhe arrijnë rreth 50.300 milion lekë nga 48.500 milion të miratuara nga ERE për vitin 2022 duke rezultuar me një diferencë prej rreth 1.8 miliard lekë.

Bazuar në nevojën për të ardhura prej rritjes së kostos së blerjes së energjisë dhe pasiguritë e realizimit të kostove të tjera të furnizimit, vlerësojmë se çmimi prej 42 lekë/kwh për konsumin familjar mbi 800 kwh/muaj rekuperon koston e blerjes së energjisë duke siguruar likuiditetin e nevojshëm për FSHU sh.a. për garantimin e sigurisë së furnizimit me energji elektrike, e cila rezulton sipas përlllogaritjeve të evidentuara në tabelën në vijim:

Kategorite e klienteve	Leke/kWh	Sasite GWh	Te ardhurat Milion/lekë
<i>familjar mbi 800</i>	42.00	57.43	2,412.23
Kategorite e klienteve	Leke/kWh	Sasite GWh	Te ardhurat Milion/lekë
<i>familjar mbi 800</i>	9.50	57.43	545.62
<i>Diference në të ardhura për konsumin familjar mbi 800 kwh/muaj</i>			1,866.61

Në përfundim, theksojmë se bëhet e nevojshme vënia në dukje shoqërisë FSHU sh.a., që periudha e leximit periodik të matësit të energjisë elektrike të klientëve fundorë duhet të kryhet duke respektuar në mënyrë rigoroze afatin e përcaktuar prej 30 ditë kalendarike, në nenin 11 të kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë të miratuar me vendimin nr. 15, datë 10.01.2018 të Bordit të ERE, me qëllim mbrojtjen e të gjithë klientëve familjarë nga çdo keqfaturim i mundshëm.

**Për gjithë sa më sipër si dhe në mbështetje të neneve 1, 83, 85 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 90 të Ligjit Nr. 43/2015 “Per Sektorin e Energjise Elektrike” i ndryshuar; neni 12 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 584, datë 08.10.2021 i ndryshuar “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, e ndryshuar; VKM-s nr. 456, datë 29.6.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të**

**cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; nenit 7, pika “g” të “Metodologjisë së Përcaktimit të Çmimeve për Shitjen e Energjisë Elektrike me Pakicë tek Klientët Fundorë që Furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal”, miratuar me vendim të bordit të ERE-s nr. 189, datë 23.11.2017 si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë nr. 96, datë 17.06.2016, i propozojmë Bordit të ERE-s:**

- 1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike prej 42 lekë/kWh për konsumin mbi 800 kWh/muaj për klientët familjarë për periudhën 1 Tetor – 31 Dhjetor 2022.**